



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1872/prot
/5

Tiranë më 30.11.2022

VENDIM

Nr. 64, Datë 25.11.2022

PËR

**“HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL”
NË “NDËRTIM SOFTWARE”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS, TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3, pika 2, shkronja b), nenit 35, pika 1), neni 75, pika 6, neni 49, pika 1, shkronja a), Statutit të Universitetit të Tiranës miratuar nga MASR – ja, me urdhërin nr. 816 datë 26.12.2018, nenit 5, pika 1, shkronja a), nenit 7, shkronja b), nenit 31, shkronja f), nenit 91, nenit 93, udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, kreu IV, shkronja a), i ndryshuar “hapja, riorganizimi dhe mbyllja e programeve të studimit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” i ndryshuar, pika 2.9, shkronja c), si dhe vendimit nr. 31, datë 23.11.2022 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës “Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në ndërtim software, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- Të miratojë hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master Profesional” në “Ndërtim Software”, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024,
- Burimi i financimit për këtë program studimi do të jetë tarifa e shkollimit për program dhe pa efekte financiare shtesë nga buxheti i UT-së,
- Ky vendimi i përcillet Rektorit, Administratorit të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, UT-së,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

